



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve  
Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 1.11.2023

Nr: 814

Ora: 14:00

**VENDIM**

**PËR**

**VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE DAKTILOSKOPIKE TË MBLEDHURA NGA PAJISJET E IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të neneve 14, 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, dhe 167/2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**VENDOSIM:**

1. Procesi i verifikimit të të dhënave daktiloskopike të mbledhura nga pajisjet e identifikimit elektronik për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2023, bëhet nga administrata e KQZ-së për identifikimin e rasteve të dyshuara të votuesve të shumëfishtë.
2. Në përfundim të verifikimit hartohet raporti paraprak, të cilin Sekretari i Përgjithshëm ia paraqet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
3. Raporti paraprak i dërgohet për njohje subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në procesin e këqyrjes, të cilat brenda një afati prej 5 (pesë) ditësh mund të parashetrojnë komentet e tyre.
4. Raporti përfundimtar për këqyrjen e të dhënave PEI miratohet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
5. Ngarkohet administrata e KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Lealba PELINKU**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**